

IHD NË SHQIPËRI NË NIVELE REKORD T1 2026

Janar - Mars 2026, fluksi i IHD-ve kapi vlerën rekord prej €404 milionë

Stoku Total i IHD: Kapërcehet për herë të parë pragu i €17 Miliardëve



Austria

Për tremujorin e parë të vitit 2026, fluksi i investimeve të huaja u dominua nga Austria me €60 milionë (14.8%)



Pasuritë e paluajtshme

Pasuritë e paluajtshme udhëhoqën interesin e investitorëve me 42.5% të fluksit total (ose €172 milionë)



IHD në Shqipëri në nivele rekord | T1 2026

Tremujori i parë i vitit 2026 konfirmon zyrtarisht interesin në rritje të investitorëve të huaj për Shqipërinë. Sipas të dhënave më të fundit nga Banka e Shqipërisë, vendi ynë ka shënuar performancën më të lartë historike për këtë periudhë të vitit.

Fluksi i Ri i Investimeve: Rritje me 11.6%

Gjatë periudhës Janar – Mars 2026, fluksi i IHD-ve kapi vlerën rekord prej €404 milionë.

-Kjo përfaqëson një rritje prej +11.6% (ose €42 milionë më shumë) krahasuar me T1 2025, ku fluksi ishte €362 milionë.

Stoku Total i IHD: Kapërcehet për herë të parë pragu i €17 Miliardëve

Në fund të muajit mars 2026, stoku total i investimeve të huaja në vend arriti vlerën historike prej €17.44 miliardë (nga €16.99 miliardë që ishte në fund të vitit 2025, një rritje neto prej €444 milionë brenda vetëm 3 muajve).

Kush po investon më shumë në Shqipëri? (T1 2026)



-Sipas Fluksit të Ri: Për tremujorin e parë të vitit 2026, fluksi i investimeve të huaja u dominua nga Austria me €60 milionë (14.8%), e ndjekur nga Italia, Holanda, Turqia dhe Kosova.

-Sipas Stokut Historik: Holanda mban peshën kryesore të kapitalit të akumuluar në vend me €2.83 miliardë (16.2%), e pasuar nga Zvicra (€2.37 miliardë) dhe Kanada (€2.08 miliardë).

Cilët janë sektorët më të kërkuar?

-Sipas Fluksit të Ri: Pasuritë e paluajtshme udhëhoqën interesin e investitorëve me 42.5% të fluksit total (ose €172 milionë), të ndjekura nga aktivitetet financiare me 16.8%.

-Sipas Stokut Historik: Sektori i Energjisë, Gazit dhe Furnizimit me Ujë mbetet shtylla kryesore e investimeve historike në Shqipëri, duke përfaqësuar 22.4% të stokut total me një vlerë prej €3.91 miliardë.



AIDA çel fushatën e takimeve “Door-to-Door” për investitorët e huaj në Shqipëri (2026)”

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) informon se gjatë muajit qershor ka vijuar zbatimin e fushatës “Door-to-Door”, në kuadër të shërbimeve After-Care për investitorët e huaj që operojnë në Shqipëri.

Kjo nismë zhvillohet në bashkëpunim me Ministrinë e Ekonomisë dhe Inovacionit, Ministrinë e Shtetit për Pushtetin Vendor, si dhe me mbështetjen e ambasadave të Gjermanisë, Zvicrës, Holandës, Austrisë, Italisë dhe Hungarisë. Ajo synon forcimin e koordinimit institucional dhe dialogut të drejtpërdrejtë me komunitetin e biznesit.

Përmes këtyre takimeve, AIDA synon të jetë më pranë kompanive të huaja që operojnë në vend, për të identifikuar nevojat, sfidat dhe mundësitë e tyre për zhvillim të mëtejshëm. Takimet u fokusuan në çështje si proceset administrative, infrastruktura, burimet njerëzore të kualifikuara, planet për zgjerim, si dhe mundësitë për ri-investime dhe rritje të qëndrueshme.

Gjatë muajit qershor 2026 u zhvilluan katër takime “door-to-door” me kompanitë: Maccaferri Albania, Forschner Albania, Vega Group dhe AlbaCo Shoes.

Takimet u fokusuan në:

- Proceset administrative
- Infrastruktura
- Burimet njerëzore të kualifikuara
- Planet për zgjerim
- Mundësitë për ri-investime dhe rritje të qëndrueshme



Takimi i parë Aftercare me kompaninë Maccaferri

AIDA nisi fushatën e takimeve Aftercare me kompaninë italiane Maccaferri Albania, në praninë e Drejtoreshës Ekzekutive të AIDA-s, znj. Laura Saro, dhe Zëvendësministrit të Ekonomisë, z. Enkelejd Musabelliu.

Maccaferri operon në prodhimin dhe tregtimin e rrjetave të çelikut për kontrollin e erozionit dhe stabilizimin e terrenit. Gjatë takimit u diskutua mbi aktivitetin e kompanisë dhe sfidat me të cilat përballet, veçanërisht ato që lidhen me kursin e këmbimit dhe mungesën e instrumenteve financiare për menaxhimin e rrezikut financiar. U shkëmbyen gjithashtu mendime mbi mundësitë për përmirësimin e klimës së biznesit për investitorët e huaj.



Takimi i dytë Aftercare me kompaninë Forscher Albania

IDA zhvilloi takimin e radhës me kompaninë Forscher Albania, pjesë e grupit gjerman Forscher, e cila operon në Shqipëri që prej vitit 2015 në fushën e prodhimit të kabllove dhe komponentëve për industrinë automotivë.

Gjatë takimit u diskutua mbi ecurinë e aktivitetit dhe sfidat e kompanisë, me fokus në përmirësimin e infrastrukturës lidhëse dhe forcimin e bashkëpunimit me institucionet e arsimit profesional për sigurimin e një force pune të kualifikuar.


AIDA rikonfirmoi angazhimin e saj për të mbështetur investitorët ekzistues në Shqipëri, përmes dialogut të vazhdueshëm, koordinimit ndërinstitucional dhe adresimit të çështjeve që ndikojnë në zhvillimin dhe zgjerimin e aktivitetit të tyre në vend.

Takimi i tretë Aftercare pranë Vega Group

AIDA zhvilloi takimin me Vega Group, kompani që operon në sektorin e energjisë së rinovueshme, stacioneve të karikimit dhe sistemeve fotovoltaike.

Kompania ka zgjeruar aktivitetin në Shqipëri dhe rajon, duke përfshirë Kosovën, Maqedoninë e Veriut, Italinë dhe vende të tjera. Gjatë takimit u prezantuan projektet aktuale, përfshirë një projekt fotovoltaiik 64 MW në Fier dhe projekte të tjera energjetike në zhvillim.

AIDA vlerësoi kontributin e Vega Group në zhvillimin e sektorit të energjisë së rinovueshme në Shqipëri dhe rajon, si dhe rikonfirmoi angazhimin e saj për të mbështetur investitorët ekzistues përmes dialogut të vazhdueshëm, koordinimit ndërinstitucional dhe adresimit të çështjeve që ndikojnë në zhvillimin dhe zgjerimin e aktivitetit të tyre në vend.



Takimi i katërt Aftercare pranë Albaco shoes

IDA zhvilloi vizitë pranë kompanisë AlbaCo Shoes, një investitor italian me mbi 33 vite prezencë në Shqipëri.

Gjatë takimit u diskutuan problematikat dhe sfidat e hasura ndër vite, si dhe çështjet që ndikojnë në aktivitetin e përditshëm të kompanisë. Përfaqësuesit e AIDA-s vizituan ambientet e fabrikës dhe u njohën nga afër me procesin e prodhimit.

AIDA rikonfirmoi angazhimin për adresimin e çështjeve të evidentuara dhe për përcjelljen e tyre pranë institucioneve përkatëse, me qëllim mbështetjen e investitorëve ekzistues dhe përmirësimin e klimës së biznesit në Shqipëri.



Tetor 2026 : dita kur e ardhmja e mikpritjes mbledhet në tiranë | “Future Hospitality Forum”

Më 2 tetor 2026, AIDA do të organizojë për herë të parë edicionin Future Hospitality Forum, një forum i nivelit të lartë që synon të krijojë mundësi bashkëpunimi ndërmjet zhvilluesve shqiptarë të projekteve turistike dhe markave më të njohura ndërkombëtare të industrisë së mikpritjes.


I konceptuar si një platformë investimi dhe partneriteti, forumi do të mbledhë investitorë, zhvillues, ekspertë të sektorit dhe marka prestigjioze ndërkombëtare hoteliere me 4 dhe 5 yje, duke mundësuar partneritete strategjike dhe zhvillimin e projekteve turistike në përputhje me standardet më të larta të industrisë.

Future Hospitality Forum synon të shndërrohet në ngjarjen kryesore të turizmit dhe mikpritjes në Shqipëri, duke nxitur investime cilësore dhe zhvillim të qëndrueshëm të sektorit.

Përmes lidhjes së drejtpërdrejtë mes zhvilluesve vendas dhe operatorëve ndërkombëtarë, eventit pritet të kontribuojë në rritjen e pranisë së markave globale në Shqipëri, përmirësimin e standardeve të akomodimit dhe forcimin e pozicionit të vendit si destinacion konkurrues për investime në turizëm.



 2 Tetor 2026

 Teatri Kombëtar i Operas dhe Baletit (TKOB), Tiranë

Permbillet me sukses cikli i sesioneve informuese “Mbështetje me Fonde për Zhvillimin e Biznesit” 2026

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) zhvilloi me sukses tre sesione informuese në kuadër të skemës së granteve “Mbështetje me Fonde për Zhvillimin e Biznesit” 2026. Sesioni i tretë dhe i fundit u mbajt si përmbyllje e këtij cikli takimesh, ku sipërmarrës, përfaqësues biznesesh dhe subjekte të interesuara u njohën me kriteret e aplikimit, dokumentacionin e nevojshëm dhe procedurat për përfitimin nga fondet mbështetëse të AIDA-s.

Në kuadër të këtij procesi, më 9 Qershor 2026, ora 16:30 u mbyll edhe afati i aplikimeve për këtë thirrje, duke shënuar përfundimin e fazës së pranimit të aplikimeve dhe kalimin në fazat pasuese të vlerësimit.



AIDA falënderon të gjithë sipërmarrësit, përfaqësuesit e bizneseve dhe subjektet e interesuara për pjesëmarrjen dhe angazhimin e tyre aktiv në këtë cikël informues. Agjencia mbetet e përkushtuar të vijojë mbështetjen për sipërmarrjen shqiptare, duke ofruar mundësi konkrete për zhvillim, konkurrueshmëri dhe rritje të qëndrueshme.



AIDA në Forumi Ekonomik “Poloni-Shqipëri” | 19 Qershor, Varshavë

AIDA mori pjesë në Forumin Ekonomik “Poland – Albania Business Mixer”, që u zhvillua në Varshavë, një aktivitet që mbledhi përfaqësues institucionalë dhe biznesesh nga Shqipëria dhe Polonia, me synimin për të nxitur bashkëpunimin ekonomik, tregtar dhe investues ndërmjet dy vendeve.

Aktiviteti u hap nga përfaqësues të lartë të institucioneve polake dhe shqiptare, përfshirë z. Michał Baranowski, Zëvendësministër i Shtetit në Ministrinë e Zhvillimit Ekonomik dhe Teknologjisë së Polonisë, z. Enkelejd Musabelliu, Zëvendësministër i Ekonomisë dhe Inovacionit të Shqipërisë, z. Artur Osuchowski nga PAIH dhe Ambasadorja e Shqipërisë në Poloni, znj. Mimoza Halimi.

Gjatë forumit, AIDA prezantoi “Invest in Albania”, duke promovuar avantazhet konkurruese të vendit dhe mundësitë për investime. Programi vijoi me prezantime nga BGK – Banka Polake e Zhvillimit, TEDA Tirana, DURANA Tech Park dhe ASDRE, si dhe nga kompani shqiptare dhe polake që ndanë eksperiencat dhe potencialin e tyre për bashkëpunim.

Forumit u përmbyll me takime B2B dhe sesione networking, ku bizneset nga të dy vendet zhvilluan kontakte të reja dhe diskutuan mundësi konkrete për partneritete, tregti dhe investime të ndërsjella.



AIDA dhe AKBN nënshkruan një Memorandum Mirëkuptimi | 24 Qershor

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), e përfaqësuar nga Drejtoresha Ekzekutive, Znj. Laura Saro, dhe Agjencia Kombëtare e Burimeve Natyrore (AKBN), e përfaqësuar nga Drejtori Ekzekutiv, Z. Genci Tërpo, nënshkruan një Memorandum Bashkëpunimi (MoU).

Ky memorandum shënon një hap të rëndësishëm drejt bashkërendimit të forcave për:

- Promovimin e investimeve në sektorët e burimeve natyrore (energji, miniera dhe hidrokarbure).
 - Lehtësimin e komunikimit dhe ofrimin e një asistence më të shpejtë e cilësore për investitorët vendas dhe të huaj.
 - Shkëmbimin e informacionit dhe koordinimin teknik për mbështetjen e projekteve me interes strategjik.
- Përmes këtij partneriteti, AIDA dhe AKBN do të organizojnë aktivitete të përbashkëta për të prezantuar potencialin që Shqipëria ofron në sektorin energjetik dhe minerar.

Bashkë, krijojmë një klimë më të sigurt dhe tërheqëse për investimet e qëndrueshme!



AIDA – Takim informues mbi politikat mbështetëse për sipërmarrjen | 24 Qershor, Vlorë

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) mori pjesë në një takim informues në Vlorë mbi politikat institucionale në mbështetje të sipërmarrjes.

Në fokus të diskutimeve ishin programet dhe instrumentet mbështetëse për start-up-et, ndërmarrjet e vogla dhe të mesme, si dhe sektorët prodhues e bujqësor, me qëllim rritjen e standardeve të shërbimeve, modernizimin e proceseve të prodhimit, nxitjen e inovacionit dhe certifikimin e markave.

Në aktivitet morën pjesë përfaqësues institucionalë dhe të biznesit, mes tyre znj. Ardita Kuçi (AZHBR), z. Arjan Ymeri (Start Up Albania), znj. Ines Muçostepa (UCCIAL), znj. Albana Zyka (AIDA), përfaqësues nga Ministria e Ekonomisë dhe Inovacionit, si dhe sipërmarrësja znj. Era Xhabafti.

Takimi shërbeu si një platformë për dialog dhe bashkëpunim ndërinstitucional, me synim forcimin e ekosistemit të sipërmarrjes dhe nxitjen e zhvillimit ekonomik të qëndrueshëm.



AIDA si Partner Strategjik në “AI Business Summit II” | 25 Qershor 2026

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) mori pjesë si Partner Strategjik në AI Business Summit II –AI in Practice, i cili u zhvillua në 25 Qershor, në Innovation Hub, Piramida, Tiranë. Ky samit, i organizuar nga Shoqata e Biznesit Grek në Shqipëri (Hellenic Business Association), bëri bashkë përfaqësues të institucioneve publike, sektorit financiar, sipërmarrjes dhe ekspertë të teknologjisë për të diskutuar mbi rolin e Intelgjencës Artificiale në zhvillimin ekonomik dhe transformimin digjital.

Paneli: “Building Albania’s AI and Digital Innovation Ecosystem”

AIDA u përfaqësua në këtë aktivitet nga znj. Sara Zotaj, Drejtore e Drejtorisë së Investimeve të Huaja Direkte, e cila mori pjesë në panelin “Building Albania’s AI and Digital Innovation Ecosystem”, ku diskutoi mbi mundësitë për zhvillimin e ekosistemit të inteligjencës artificiale në Shqipëri, forcimin e inovacionit dhe tërheqjen e investimeve në sektorët me potencial të lartë teknologjik.

Fokusi i Diskutimit

Gjatë bashkëbisedimit u trajtuan pikat kyçe për ndërtimin e një ekosistemi të qëndrueshëm digjital në Shqipëri:

- Mundësitë e reja për zhvillimin e inovacionit dhe integrimin e AI në praktikën e biznesit.
- Tërheqja e investimeve të huaja direkte në sektorët me potencial të lartë teknologjik.
- Forcimi i bashkëpunimit mes institucioneve publike, akademisë dhe sektorit privat.

Pjesëmarrja e AIDA-s në këtë samit rikonfirmon angazhimin e vazhdueshëm të institucionit për të mbështetur inovacionin dhe për ta promovuar Shqipërinë si një destinacion konkurrues dhe tërheqës për investimet në teknologji.



Histori Suksesi Biznese që rriten me Mbështetjen e AIDA



Nga panairi në marrëveshje konkrete | Zdrava Group zgjeron bashkëpunimet ndërkombëtare

Zdrava Group, një nga kompanitë lider në agro-përpunimin e fruta-perimeve, me mbi 32 vite eksperiencë dhe prezencë të konsoliduar në tregun shqiptar, si dhe në tregje ndërkombëtare, ishte pjesë e Pavijonit Shqiptar në panairin Food Expo Greece 2026 (14–16 mars), me mbështetjen e AIDA-s.

Pjesëmarrja në këtë panair u konkretizua me rezultate të prekshme për kompaninë, duke mundësuar krijimin e kontakteve të reja tregtare dhe finalizimin e një marrëveshjeje bashkëpunimi me kompaninë Minex. Gjithashtu, Zdrava Group ndodhet në një fazë të avancuar negociatash me kompaninë Limpol në Poloni dhe ka nisur bashkëpunimin me rrjetin e supermarketeve Bozo në Kroaci.

Ky sukses dëshmon edhe një herë ndikimin konkret të mbështetjes së AIDA-s në promovimin e produkteve shqiptare, zgjerimin e rrjeteve të bashkëpunimit dhe rritjen e pranisë së bizneseve shqiptare në tregjet ndërkombëtare.

AIDA ju fton të merrni pjesë në: MOS 2026 | 16–20 Shtator 2026 Slloveni

Thirrje për pjesëmarrje në Pavijonin Kombëtar Shqiptar në panairin MOS 2026, Slloveni

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA) fton bizneset shqiptare të shprehin interesin për pjesëmarrje në Pavijonin Kombëtar Shqiptar në panairin ndërkombëtar MOS 2026, i cili do të zhvillohet në Celje, Slloveni, në datat 16–20 shtator 2026.

MOS është një nga panairët më të mëdha të biznesit dhe tregtisë në Evropën Qendrore dhe Juglindore, duke ofruar mundësi të vlefshme për promovimin e produkteve dhe shërbimeve, krijimin e kontakteve të reja tregtare dhe zgjerimin në tregjet ndërkombëtare. Në kuadër të promovimit të eksporteve shqiptare dhe ndërkombëtarizimit të bizneseve vendase, AIDA do të organizojë Pavijonin Kombëtar Shqiptar, ku kompanitë e përzgjedhura do të kenë mundësinë të prezantojnë produktet dhe shërbimet e tyre përpara një audience të gjerë profesionale.

Mbështetje për zhvillimin e industrisë së modës në Shqipëri | Kompania Melgushi shpk

Me mbi dy dekada aktivitet në industrinë e modës, kompania Melgushi shpk ka vijuar të zgjerojë aktivitetin e saj përmes markës së vet Lovelo, e cila ofron produkte veshjeje për grupmosha dhe kategori të ndryshme konsumatorësh.

Falë mbështetjes së AIDA-s, kompania përfitoi financim për blerjen e tre makinerive të reja, një investim që do të kontribuojë në rritjen e cilësisë, inovacionit dhe zhvillimin e produkteve të reja për tregun.

Ky është një shembull konkret se si mbështetja për bizneset shqiptare ndihmon në forcimin e kapaciteteve prodhuese dhe rritjen e konkurrueshmërisë së tyre në treg.

Sektorët prioritarë për pjesëmarrje janë:

- Materiale ndërtimi dhe produkte për ndërtim
- Energji e rinovueshme
- Mobilje dhe përpunim druri
- Ushqime dhe pije
- Turizëm dhe hospitality

Celje, Slloveni
16–20 Shtator 2026

Bizneset e interesuara duhet të dërgojnë sa më shpejt shprehje interesi në adresën zyrtare:
Info@aida.gov.al

MOS 58

Ftesë për pjesëmarrje B2B Shqipëri – Indi | Mundësi Tregtie dhe Investimi

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve (AIDA), në bashkëpunim me Federatën e Organizatave të Eksportit të Indisë (FIEO), do të organizojë gjatë muajit korrik një sesion virtual B2B Shqipëri-Indi, me fokus krijimin e lidhjeve të biznesit dhe eksplorimin e mundësive të reja të bashkëpunimit ndërmjet kompanive shqiptare dhe atyre indiane.

Sesioni synon të identifikojë partnerë potencialë dhe të nxisë bashkëpunimin në sektorët:

- Karburante minerale dhe energji
- Makineri dhe produkte inxhinierike
- Qeramika
- Tekstile
- Produkte agro-ushqimore
- Produkte farmaceutike
- ICT / BPO

Bizneset shqiptare të interesuara ftohen të dërgojnë sa më shpejt shprehjen e interesit në adresën zyrtare të AIDA-s: info@aida.gov.al.

Për më shumë mundësi bashkëpunimi dhe njoftime të reja, ndiqni AIDA-n në rrjetet sociale dhe në faqen zyrtare të internetit.

Sesion Virtual

B2B: SHQIPËRI – INDI

MUNDËSI TREGTIE DHE INVESTIMI

Mundësi bashkëpunimit në sektorët:

- Karburante minerale dhe energjia
- Makineri dhe produkte inxhinierike
- Qeramika
- Tekstile
- Produktet agro-ushqimore
- Produktet farmaceutike
- ICT / BPO

Bizneset shqiptare të interesuara duhet të dërgojnë sa më shpejt shprehje interesit në adresën zyrtare të AIDA-s: info@aida.gov.al

Sustainable Textile

EcoDesign Regulation & Readiness Assessment Tool (ERAT)

Join the first regional webinar for BSOs and export-ready companies in Value-added textile industry to discover the EcoDesign Regulation and Readiness Assessment Tool (ERAT), and learn how to strengthen readiness for ESPR, Digital Product Passports, EPR, and ESG requirements.

AIDA ju informon mbi thirrjen më të re të publikuar: ELEVATEX Open Call 2026 – Funding Opportunities for Textile SMEs

Agjencia Shqiptare e Zhvillimit të Investimeve vijon informimin e të gjithë palëve të interesuara mbi publikimin e skemave të reja financiare, në kuadër të mbështetjes së ndërmarrjeve mikro, të vogla dhe të mesme.

Në portalin “Akses në Financë” mund të gjeni thirrjen më të re të publikuar: ELEVATEX Open Call 2026 – Funding Opportunities for Textile SMEs

Për t'u njohur me thirrjen, kushtet e pranimit, masën e financimit dhe më shumë, vizitoni platformën në linkun: <https://aida-smefinance.gov.al/financial-schemes/elevatex-open-call-2026-funding-opportunities-for-textile-smes>

EUR 30.000

ELEVATEX Open Call 2026

20 SELECTED TEXTILE SMES

APPLICATION TIMELINE
01.06.2026-31.06.2026

Co-funded by the European Union

FINANCE

Ftesë për pjesëmarrje në webinarin “Tekstile të Qëndrueshme

AIDA fton kompanitë e sektorit të tekstitit të marrin pjesë në webinarin “Tekstile të Qëndrueshme: Rregullorja e Ekodizajnit dhe Mjeti për Vlerësimin e Gatishmërisë (ERAT)”, i cili do të zhvillohet më 12 qershor 2026, ora 09:30 am, në platformën Zoom.

Aktiviteti organizohet nga AIDA dhe Proeksport Albania (PEA), me mbështetjen teknike të Programit Zviceran për Promovimin e Importit (SIPPO), dhe synon të informojë kompanitë eksportuese të tekstitit mbi kërkesat e reja të Bashkimit Evropian për qëndrueshmërinë dhe ekodizajnin.

Gjatë webinarit, ekspertët e SIPPO-s do të prezantojnë mjetin ERAT (Ecodesign Readiness Assessment Tool), si dhe zhvillimet më të fundit lidhur me:

- Rregulloren për Ekodizajnin e Produkteve të Qëndrueshme (ESPR),
- Pasaportën Digjitale të Produktit (DPP),
- Përgjegjësinë e Zgjeruar të Prodhuesit (EPR) dhe raportimin ESG.

Pjesëmarrja është pa pagesë, ndërsa regjistrimi është i detyrueshëm deri më 11 qershor 2026, ora 12:00.

Për t'u regjistruar, klikoni në linkun e mëposhtëm:

<https://us06web.zoom.us/join/register/e4fw7C4FQsi-Rpi58UxATQ#/>

📅 12 Qershor 🕒 09:30